



**BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE**  
**KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE**

06.02.2021

Zbatimi i modeleve të dhura të organizimit dhe drejtimit, kontrolli i brendshëm i njësive ekonomike të biznesit dhe përdorimi i sistemeve të informacionit dhe informatikës

**TEZA 1**

**ALTERNATIVA (10 x 1 pikë)**

**1. Ne menaxhimin organizativ sinergjia nenkupton:**

- a. Shkembimi i informacionit ndermjet subjekteve.
- b. Sasite ku kompanite llogarisin fitimet nga njera – tjetra.
- c. Fuqia optimale e furnitoreve.
- d. Organizimi ideal i burimeve
- e. Perfitime me te medha nepermjet bashkepunimit sesa orientimit individual
- f. Zbatimi i kodit të punës
- g. Të gjitha më sipër
- h. Asnjëra

**Përgjigje e saktë është alternativa E**

**2. Faktor përcaktues qe ndikon ne vendim-marrje eshte:**

- a. Teknologjia.
- b. Krizat.
- c. Koha.
- d. Informacioni.
- e. Teknika.
- f. Pozicioni gjeografik
- g. Të gjitha së bashku
- h. Asnjëra

**Përgjigje e saktë është alternativa D**

**3. Cili nga pershkrimet mbi menaxhimin eshte me i sakti:**

- a. Të realizojë misionin dhe qëllimet e organizatës.
- b. Ta bëjë punën e punonjësve produktive.
- c. Arti i arritjeve nepermjet njerezve.

- d. Të menaxhojë impaktet e jashtme dhe përgjegjësitë sociale.
- e. Të realizojë fitimet
- f. Alternativa d) dhe e)
- g. Të gjitha së bashku
- h. Asnjëra

#### Përgjigje e saktë është alternativa C

#### 4. Përhapja e madhe e kompjuterave ka sjellë avantazh si më poshtë:

- a. Ruajtja e informacionit në sasi të mëdha
- b. Shpejtësia në përpunimin e informacionit
- c. Besueshmëria
- d. Kontrolli
- e. Përdorim të rrjeteve sociale
- f. Rritja e shpejtësisë së komunikimit
- g. Të gjitha bashkë
- h. Asnjë nga më sipër

#### Përgjigje e saktë është alternativa G

#### 5. Një auditues IT, i ngarkuar me auditimin e zhvillimit të një programi kompjuterik, zbulon se programi është zhvilluar në masën mbi 80%, por ka kapërcyer afatet kohore me 10% dhe kostot e zhvillimit me 25%. Në këto kushte audituesi IT duhet të:

- a. Raportoje se organizata nuk ka efektivitet në menaxhimin e projekteve.
- b. Rekomandojë zëvendësimin e menaxherit të projektit.
- c. Rivlerësojë strukturën e supervizimit IT.
- d. Rivlerësojë dinamikën e projektit në fjalë.
- e. Të gjitha më sipër
- f. Asnjëra

#### Përgjigje e saktë është alternativa C

#### 6. Njohja e entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë dhe kontrollin e brendshëm është:

- a. një proces i vazhdueshëm dhe dinamik i mbledhjes, azhornimit dhe i analizës që ndodh para periudhës së auditimit;
- b. një proces i vazhdueshëm dhe dinamik i mbledhjes, azhornimit dhe i analizës që ndodh pas periudhës së auditimit;
- c. një proces i vazhdueshëm dhe dinamik i mbledhjes, azhornimit dhe i analizës që ndodh gjatë gjithë periudhës së auditimit;
- d. një proces i ndërprerë dhe statik i mbledhjes, azhornimit dhe i analizës që ndodh vetëm në disa faza specifike të periudhës së auditimit.
- e. Të gjitha më sipër
- f. Asnjëra

#### Përgjigje e saktë është alternativa C

**7. Elementë të kontrollit manual mund të jenë më të përshtatshëm në rrethanat e mëposhtme:**

- a. Aktivitete të kontrollit ku mënyra specifike të kontrollit mund të dizajnohen në mënyrë adekuate dhe automatike;
- b. Volum i lartë i transaksioneve rrjedhëse;
- c. Situata ku gabimet mund të parashikohen, paraprihen, apo kapen e korrigojnë nga parametrat e kontrollit që janë automatike;
- d. Volum i ulët i transaksioneve.
- e. Të gjitha më sipër
- f. Asnjëra

Përgjigje e saktë është alternativa D

**8. Cila prej mediave të telekomunikimit ka shpejtësi më të lartë transmetimi?**

- a. Kabujt dysh
- b. Kabujt koaksial (dyllëzuar)
- c. Fibrat optike
- d. Transmetimi me mikrovalë
- e. DSL
- f. Satelitorë
- g. Të gjitha kanë të njëjtën shpejtësi
- h. Asnjëra

Përgjigje e saktë është alternativa C

**9. Sistemi i automatizuar i Burimeve Njerëzore (BNJ) përmban një tabelë të pagesave që i përshtatet klasifikimeve të punës së punonjësit. Kontrolli më i mirë që mund të ushtrohet për të siguruar që tabela të përditësohet në mënyrë korrekte vetëm për ndryshimet e vlefshme në pagesë, është duke:**

- a. I kërkuar një eprori në departament, që nuk ka aftësi për të ndryshuar tabelën, të krahasojë ndryshimet me autorizimin e nënshkruar nga menaxhimi.
- b. Siguruar që sistemi i automatizuar të përmbajë kontrolle për redaktimin dhe arsyetimin.
- c. Kërkuar që të gjitha ndryshimet në pagesa të nënshkruhen nga punonjësi për të verifikuar që ndryshimi është përditësuar në mirëbesim të punonjësit.
- d. Kufizuar qasjen në tabelën e të dhënave për të lejuar vetëm menaxherët dhe eprorët e linjës që kanë autoritetin për të përcaktuar normën e pagesës.
- e. Alternativa a) dhe c)
- f. Alternativa a) dhe d)
- g. Të gjitha më sipër
- h. Asnjëra

Përgjigje e saktë është alternativa A

**10. Cilat nga zërat e mëposhtëm, është emërtuar bazuar në klasifikimin e kostos për qëllime të vendimarrjes**

- a. shpenzime për sigurime
- b. kostoja administrative
- c. kostoja oportune
- d. shpenzime karburanti
- e. shpenzime kancelarie
- f. shpenzime noterie dhe ligjore
- g. të gjitha më sipër
- h. asnjëra

**Përgjigje e saktë është alternativa C**

## **PYETJE ME SHTJELLIM (4 pikë secila pyetje)**

1. Nqs do te ishe drejtues i nje shoqerie të vogël auditimi, si do t'i motivoje njerëzit që do të punonin me ty?

### **Përgjigje:**

Për të motivuar një person do të përdorja këto rrugë:

1. Më shumë para;
  2. Tituj pune, kushte materiale pune, etj.;
  3. Më shumë sfidë profesionale për të përdorur aftësitë që ka dhe zhvilluar të tjera (do i jepja detyra të një niveli pak më të lartë vështirësie);
  4. Më shumë autonomi (do i jepja të drejtën që të marrë vendime vetë në lidhje me metodën e punës, ritmin, kontrollin e cilësisë, etj.);
  5. Mirënjohje publike, etj.
2. Përmbledhni ndikimin e strategjisë, të përmasave, të teknologjisë dhe të mjedisit mbi strukturën e organizatës.

### **Përgjigje:**

Teza “strategjia përcakton strukturën” argumenton se struktura duhet të reflektojë dhe mbështesë strategjinë. Kur strategjia orientohet në një sasi modeste produktesh, edhe struktura duhet të zhvendoset nga forma organike drejt asaj mekanike. Gjithashtu, me rritjen e madhësisë rritet specializimi, formalizimi dhe diferencimi vertikal dhe horizontal. Sa më tepër të rriten organizatat, aq më tepër priren ato të formalizohen, specializohen dhe të jenë mekanike. Nëse faktorët e tjerë mbahen konstantë, sa më rutinë të jetë teknologjia që përdor organizata, aq më mekanike do të jetë ajo. Sa më pak rutinë teknologjia, aq më organike duhet të jetë struktura e organizatës. Mjediset e qëndrueshme përshtaten më mirë me organizatat mekanike, kurse mjediset dinamike përputhen më mirë me organizatat organike.

3. Listoni karakteristikat e skuadrave të punës me performancë të lartë.

### **Përgjigje:**

Skuadrat e punës me performancë të lartë karakterizohen nga qëllime të qarta, përkushtim uniform, komunikim i mirë, besim reciprok, leadership efektiv, mbështetje nga jashtë dhe brenda, aftësi negociuese dhe zotësi që lidhen me kryerjen e punës.

4. Tregoni dhe përshkruani nga dallon kujtesa RAM nga kujtesa ROM?

### **Përgjigje:**

Kujtesa RAM ose Random access memory është pjesë e kujtesës kryesore dhe i referohet mundësisë së adresimit, shfrytëzimit direkt si karakteristikë kryesore. Ajo është fleksibël, pasi mund të lexohet/shkruhet/ruhet/fshihet. Ajo negative është se me shkëputjen e energjisë, nuk ruhet asgjë në këtë lloj kujtese. Në ndryshim ROM ose Read Only Memory i referohet kujtesës së pandryshueshme që nuk fshihet me shkëputjen e energjisë dhe përdoret për ruajtjen e sigurtë të programeve të vegjël ose instruksioneve.

5. Cilët faktorë motivojnë drejtimin e kompanisë për të nënkontraktuar shërbimet IT në fushën e kontabilitetit, financës dhe kontrollit?

**Përgjigje:**

Aktivitetet IT të organizatës janë tepër teknike, mjaft dinamike, në ndryshim të vazhdueshëm dhe me kosto të lartë investimi. Kostot e vazhdueshme të trajnimit të stafit, kostot e mirëmbajtjes të sistemeve IT dhe kostot e zhvillimit të programeve (moduleve) specifike për nevojat e organizatës janë gjithashtu faktorë për outsourcing.

6. Cilat teknika audituese mund të përdorë një auditues IT për të grumbulluar të dhënat e nevojshme? Jepni shkurt arsyet e përdorimit të secilës prej tyre.

**Përgjigje:**

- a. evidencë dokumentare, përfshirë dhe rekordet elektronike;
- b. inspektim dhe observim fizik i proceseve, pajisjeve dhe operatorëve të tyre;
- c. intervistim me dizenjuesit dhe operatorët kyç të sistemit, për të kuptuar funksionimin dhe problematikat;
- d. anketim për të grumbulluar sa më shumë informacion, veçanërisht kur organizata është e madhe;
- e. flowchart-et e kontrollit të sistemit, për të kuptuar vetë audituesi, vlerësuar dhe komunikuar funksionimin e sistemit dhe siguresat e tij;
- f. procedurat analitike, për të krahasuar dhe përcaktuar nëse gjendjet e llogarive duken të arsyeshme. Këto procedura është mirë të kryhen herët në auditim, për të identifikuar zonat me risk.

7. Identifikoni dhe shpjegoni shkurtimisht komponentët e kontrollit të brendshëm të një njësie ekonomike.

**Përgjigje:**

Komponentët e kontrollit të brendshëm të një entiteti ndahen si më poshtë:

- a) Mjedisi i kontrollit (kushtet bazë për krijimin e një entiteti, ku përfshihen vlerat etike, morali, qeverisja, filozofia e drejtimit, politikat e burimeve njerëzore, delegimi i detyrave, etj).

- b) Procesi i vlerësimit të rrezikut të entitetit (përfshihet i gjithë procesi i identifikimit, vlerësimit, kontrollit dhe monitorimit të atyre ngjarjeve dhe situatave potencialisht të dëmshme për arritjen e objektivave të entitetit dhe konceptohet për të dhënë garanci të arsyeshme se këto objektiva do të arrihen.
- c) Sistemi i informacionit (përfshin proceset përkatëse të veprimtarisë, që kanë të bëjnë me raportimin financiar dhe komunikimin);
- d) Veprimtaritë e kontrollit, (të cilat janë rregulla, procedura dhe veprime që synojnë reduktimin e risqeve me synim përmbushjen e objektivave të njësisë si dhe për të nxjerrë zbatimin e vendimeve të menaxherit);
- e) Vëzhgimi i kontrolleve (nëse funksionojnë sipas qëllimit si dhe nëse janë modifikuar në mënyrën e duhur, kur ka patur ndryshime të kushteve).

8. Cilat janë karakteristikat e sistemit të informacionit dhe proceseve të biznesit në entitetet e vogla?

**Përgjigje:**

Në njësitë e vogla, sistemi i informacionit dhe proceset e lidhura të biznesit të rëndësishme për raportimin financiar, nuk është i sofistikuar sa në entitetet e mëdha, po roli i tyre është po aq domethënës. Entitete të vogla me përfshirje aktive të manaxhimit mund të mos u nevojitet përshkrime shtesë të procedurave të kontabilitetit, regjistrimeve të sofistikuar në kontabilitet, ose politika të shkruajtura. Të kuptuarit e sistemeve të entitetit dhe procedurave mund të jenë më të thjeshta në një entitet të vogël, dhe mund të jenë më të varur nga hetimet sesa nga rishikimet e dokumentave. Nevoja për të kuptuar, gjithsesi, mbetet shumë e rëndësishme.

9. Cilat janë avantazhet që i jep sistemi i teknologjisë së informacionit kontrollit të brendshëm?

**Përgjigje:**

TI i jep avantazhe kontrollit të brendshëm të:

- Në mënyrë konsistente të aplikojë rregullat e biznesit dhe të bëjnë kalkulime komplekse në volume të mëdha të dhënash dhe transaksionesh
- Rritjen e mundësive, disponueshmërisë, dhe saktësisë së informacionit.
- Lehtësim për analiza shtesë të informacionit
- Rritje e mundësisë për të monitoruar performancën e entitetit, aktivitetet dhe politikat dhe procedurat e tij
- Uljen e rrezikut që kontrolli mund të kufizohet nga mashtimet
- Rritje e mundësisë për të arritur ndarjen e detyrave duke impelentuar kontroll sigurie nëpër aplikacione, baza të dhënash, dhe sisteme operimi.

10. Tregoni cilat janë metodat që përdoren për shpërndarjen e SHPP ?

## **Përgjigje:**

Për shpërndarjen e SHPP realizohet duke përdorur koeficientët e paracaktuar. Një njësi ekonomike mund të realizojë shpërndarjen e SHPP nëpërmjet

a) Metodës tradicionale: nëpërmjet të cilës njësi ekonomike shpërndan SHPP duke përcaktuar saktë bazën e shpërndarjes (faktorin e kostos). Si bazë të shpërndarjes mund të shërbejë orët e punës direkte, ose orët e makinerisë, ose kostoja e punës direkte, ose vëllimi i prodhimit, etj.

Metoda e kostos së punës direkte përdor si bazë për shpërndarjen e shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit, shumën e kostove të punës direkte që janë llogaritur për një porosi të caktuar.

Metoda e orëve të punës direkte e kapërcen problemin e tarifave orare të ndryshme duke i rënduar shpenzimet e përgjithshme të prodhimit në bazë të numrit të orëve të punës direkte të një porosie apo procesi.

Për repartet që kanë një shkallë të lartë automatizimi metoda më e mirë është metoda e orëve të makinerive. Në një departament të tillë shpenzimet e përgjithshme të prodhimit duhet të jenë më shumë të lidhura me orët që punojnë makineritë.

b) Metoda e bazuar në aktivitetet e cila njihet ndryshe edhe si metoda ABC;

Metodat e mësipërme të shpërndarjes së shpenzimeve të përgjithshme nëpër produkte supozojnë se të gjitha shpenzimet e përgjithshme lidhen me vëllimin. Kjo do të thotë se të gjitha shpenzimet e përgjithshme të kryera janë funksion i numrit të orëve të punës direkte ose orëve të makinerive, pra i aktiviteteve të lidhura me vëllimin. Në një fabrikë

moderne, e cila prodhon shumë produkte, një pjesë e mirë e shpenzimeve të përgjithshme mund të jenë më shumë të lidhura me kompleksitetin e produktit që prodhohet sesa me numrin e njësisve të prodhuara, orët e punës direkte apo orët e makinerive. Kostoja e bazuar në aktivitet (ABC) merr në konsideratë këto aktivitete që nuk lidhen me vëllimin, të cilat krijojnë shpenzime të përgjithshme, si p.sh., numri i konfigurimeve të

makinerive ose ndryshim.

Për të përdorur me sukses një sistem ABC-je një shoqëri duhet më së pari të identifikojë aktivitetet e prodhimit jo të lidhura me vëllimin, të cilat shkaktojnë kosto. Shembuj të këtyre llojeve të aktiviteteve përmendim ndryshimet e dizajnit, inspektimet, lëvizja e materialeve, kërkesat për

materiale dhe konfigurimet e makinerive. Më pas duhet të vlerësohen kostot e kryerjes së secilit prej këtyre aktiviteteve për periudhën e ardhshme. Hapi i radhës është përcaktimi i faktorit të kostos, ose bazës, e cila do të përdoret për shpërndarjen e kostove nëpër qendrat e aktiviteteve.

Më pas për çdo aktivitet llogaritet koeficienti i paracaktuar i cili shërben për shpërndarjen e SHPP drejt objekteve të kostove.



Kujdesi duhet treguar, në faktin për të përfshirë të gjitha shpenzimet e përgjithshme të prodhimit si pjesë të kostove totale. Në rastet e njësive ekonomike që proceset e prodhimit përbëhen nga një seri operacionesh të kryera nëpër reparte apo në qendra kostosh, atëherë duhet të mbahet në konsideratë që repartet ndahen në dy kategori: reparte shërbimi dhe reparte prodhimi. Një repart shërbimi është pjesë thelbësore e një organizate, por ai nuk merr pjesë drejtpërdrejt në prodhimin e produktit. Një repart prodhimi kryen operacione prodhuese, të cilat transformojnë fizikisht njësitë që përpunohen

Metodat të cilat mund të përdoren për shpërndarjen e SHPP, në rastet kur kemi këto njësi ekonomike të cilat janë;

Metoda e shpërndarjes direkte i shpërndan kostot e një reparti shërbimi vetëm te repartet e prodhimit. Metoda e shpërndarjes direkte nuk merr parasysh shërbimet që një repart shërbimi mund të kryejë për një tjetër. Përkundrazi, kostot e reparteve të shërbimeve shpërndahen direkt vetëm nëpër repartet e prodhimit.

Shpërndarja sekuenciale ose metoda zbritëse i shpërndan kostot e reparteve të shërbimeve në mënyrë regresive nëpër repartet e tjera të shërbimeve dhe më pas bën shpërndarjen te repartet e prodhimit. Ka shumë mënyra për të përcaktuar radhën në të cilën duhet të bëhet shpërndarja e kostove të reparteve të shërbimeve. Dy nga metodat më të zakonshme janë:

- a. Numri i reparteve të tjera të shërbimit.
- b. Vlera e kostove totale të çdo reparti shërbimi.

Metoda reciproke, merr parasysh se disa reparte jo vetëm mund të ofrojnë shërbime, por gjithashtu mundet edhe të përfitojnë shërbime nga repartet e tjera. Shoqëritë, të cilat e parapëlqejnë këtë metodë përdorin softuerë që i kryejnë këto lloj llogaritjesh të ndërlikuara në bazë të një sistemi ekuacionesh.

## **USHTRIME (5 pikë secili ushtrim)**

### **Ushtrimi 1**

Nje punonjes te pyet per nje thashethem qe ka degjuar se departamenti yt dhe te gjithë punonjesit e tij do te transferohen diku ne periferi. Ti e di se thashethemi eshte i vertete, por nuk deshiron qe ta besh publik informacionin per momentin. Duke pasur frike se kjo do te cenoje moralin e departamentit dhe mund te coje ne doreheqje te parakohshme nga puna, pergjigjja nderlikohet.

**Cfare do ti thuash punonjesit tend?**

#### **Përgjigje:**

Diskutimi është etik dhe moral dhe orientohet nga sistemi i vlerave. Veprimi i duhur është të mendosh përpara sesa të veprosh. Duhet bërë gjithmonë pyetja “çfarë ndodh – nëse veprohet në një mënyrë të caktuar”. Eksperiencat dhe trajtimi me takt e inteligjence i situatës ngelet përherë diçka tepër e rëndësishme për mënyrën sesi do të veprohet. Gjithsesi, individi duhet të bëjë atë që me të vërtetë beson se është e drejtë. Por, shpesh, dhënia e një përgjigje “diplomatike”, por në thelb të mençur dhe të drejtë ngelet përherë një orientim me vlerë

### **Ushtrimi 2**

Megjithese kontrolli i sjelljes se punonjesve gjate orarit te punes dhe jashte tij mund te jete ne dukje i “padrejte dhe i pandershem”, askush nuk mund ti pengoje punedhenesit nga perfshirja ne keto praktika. Perkundrazi, nese punonjesit nuk i pelqejne rregullat e kompanise, ata mund te largohen nga puna. Nga ana tjetere, menaxheret i mbrojne veprimet e tyre ne terma te garantimit te cilesise, produktivitetit si dhe sjelljes se pershtatshme te punonjesve.

**A jane te pranueshme veprimet kontrolluese te menaxhereve per sa kohe sa punonjesit paralajmerohen se do te monitorohen?**

#### **Përgjigje:**

Punëdhënësit duhet të kenë mundësinë për të kontrolluar punonjësit, për të monitoruar kompjuterin e punës, si dhe për të kontrolluar çdo aktivitet tjetër me orientim profesional veçanërisht gjatë kohës së punës. Këto veprime jo vetëm nuk janë aspak të pazakonta, por punonjësit duhet ta dinë se ata janë duke u monitoruar nga shefat e tyre. Punonjësit punësohen vetëm për të punuar për interes të organizatës, dhe për asnjë shkak tjetër. Vetëm përdorimi i internetit gjatë punës, për shkaqe që nuk lidhen me punën ka kosto vjetore miliarda \$ në trajtën e shpërdorimit të burimeve kompjuterike, dhe rënien e produktivitetit të punës.

### **Ushtrimi 3**

Nese punon ne nje kompani, a mendon se ke te drejten e fshehtesise ne vendin e punes? A mendon se eshte e drejte, normale dhe e justifikuar qe punedhenesi yt te lexoje emailin e tua te punes, te futet ne kompjuterin tend te punes, dhe te kontrolloje “privacine” tende ne vendin e punes? Ndoshta, ajo qe kompania mund te kerkoje prej teje (dhe per te cilen ti paguhesh), eshte performanca dhe produkti, dhe jo menyra sesi ti e arrin rezultatin. Atehere, a jane te justifikueshme “interferencat” e shefave ne privacine e punonjesve ne ambientet e punes?

**Cili është mendimi yt dhe si e argumenton.**

**Përgjigje:**

Punonjësit merren në punë dhe paguhen vetëm për të punuar, për asnjë veprimtari dhe aktivitet tjetër përtej përshkrimit të punës. Veç performancës dhe produktit, çdo ndërhyrje dhe kontroll që drejtuesit mund të realizojnë gjatë kohës së punës dhe për interesa të punës, ngelet plotësisht i justifikueshëm dhe i nevojshëm jo vetëm në vlerësimin e performancës së punonjësve, por edhe për disiplinën, moralin, vlerat dhe seriozitetin që punonjësit duhet të tregojnë në raport me organizatën.

**Ushtrimi 4**

Supozoni se jeni përgjegjës për zgjedhjen e disa kujtesave sekondare për kompaninë tuaj.

**Çfarë kriteresh do të përdornit për zgjedhjen e tyre dhe përse do t'i përdornit ato?**

**Përgjigje:**

Kujtesa sekondare, ndryshe quhet edhe kujtesa e jashtme, që ruan të dhëna për një kohë të gjatë dhe mund të jetë e modifikueshme. Ndër llojet përmendim paisjet magnetike të ruajtjes (disqet magnetike), paisjet optike të ruajtjes (disqet optike), paisjet flash dhe ruajtja në cloud. Disa shembuj: floppy diskette, hard drive, magnetic strip, flash usb etj. Të përmenden edhe arsyet e zgjedhjes së tyre, si psh kosto, shpejtësia e aksesit, ruajtja, siguria etj.

**Ushtrimi 5**

Në një auditim IT mbi aksesin në llogaritë e organizatës, u gjet se:

- a) Në nivel serveri, nga 1277 llogari të testuara, 116 prej tyre aksesoheshin nga personat jo të duhur. Për shembull, 40 punonjës, kontrata e punësimit të të cilëve kishte përfunduar përpara 3 vitesh, kishin ende akses në të paktën 1 nga 25 serverat e testuar. Gjithashtu, 25 kontraktorë, shërbimet e të cilëve ishin mbyllur përpara një viti, kishin ende akses në të paktën 22 nga 25 serverat e testuar.
- b) Në nivel baze të dhënash, 10 baza të audituara përmbanin 47 llogari përdoruesish, prej të cilave, 5 llogari që aksesoheshin jo nga personat e duhur ndikonin 3 baza të dhënash.
- c) Në nivel sistemi, nga 337 llogari me rol administratori, 12 i përkisnin punonjësve që kishin kaluar në detyra të tjera brenda organizatës.

**Për sa më lart, çfarë rekomandimesh duhet të gjenerohen për të korrigjuar situatën?**

**Përgjigje:**

- a. llogaritë e punonjësve dhe kontraktorëve duhen të ç'aktivizohen menjëherë me përfundimin e kontratës së punësimit ose shërbimit;

- b. llogaritë e përdoruesve duhet të modifikojnë nivelin e aksesit në përputhje me përshkrimin e punës. Kur punonjësi ndërron pozicion, duhet të ndryshojnë privilegjet e përdoruesit menjëherë;
- c. të përpunohet një sistem sinjalizimi për llogaritë e papërdorura për një afat kohor të caktuar dhe të kuptohen shkaqet e mospërdorimit, duke vijuar me modifikimin e tyre sipas rastit;
- d. të jepet garanci se llogaritë përdoren në mënyrë unike vetëm nga një punonjës dhe mos të ndahen mes tyre.

## **Ushtrimi 6**

Asnjë sistem kontrollesh nuk mund të jetë një garanci absolute kundër rrezikut të abuzimeve apo gabimeve. Prandaj, objektivi i përshtatshëm i një sistemi kontrollesh duhet të jetë që të krijojë një “siguri të arsyeshme”, që parregullsi nuk do të ketë ose dhe në qoftë se ato ndodhin, do të identifikohen dhe do ti raportohen autoritetit përkatës.

**Duke patur parasysh këtë gjë, në ndërtimin e sistemit të kontrolleve të brendshme, cilët janë faktorët që duhet të merren në konsideratë në këtë proces?**

### **Përgjigje:**

- Të metat në konceptimin e skemës. Sistemet e kontrollit të brendshëm, duhet të konceptohen në përputhje me specifikat e organizatës, të operacioneve dhe të mjedisit ku ato do të funksionojnë, pas një analize të kujdesshme të rreziqeve që janë përfshirë në çdo rast specifik. Administratorët shpesh tentojnë të shkurtojnë procesin e konceptimit, p.sh. duke adoptuar sistemet e kontrollit të konceptuara nga një organizatë tjetër. Kjo mund të jetë e rrezikshme. Një konceptim i cunguar mund të lërë përshtypjen e sigurisë dhe garancisë, duke lënë pas dore aspekte të rëndësishme të një operacioni dhe duke krijuar pengesa për një tjetër.
- Zbatim i dobët. Edhe sistemi më i mirëkonceptuar do të arrijë objektivat e tij vetëm në sajë të një zbatimi korrekt. Administratorët dhe supervizorët e të gjitha niveleve duhet të jenë vigjilente për tu siguruar që çdonjëri brenda organizatës të pajtohet me procedurat e kontrollit që zbatohen. Madje, procedurat që vendoset të zbatohen duhet të jenë ato që punonjësit kanë vlerësuar dhe pranuar, ato që ata nuk do tentojnë të injorojnë në rastin më të parë që ato bëhen pengesë ose në momente stresi dhe tensioni të madh pune. Përmbyshja e këtij kriteri është një nga elementët kyç të konceptimit të sistemeve efektive të kontrollit. Administratorët duhet të planifikojnë gjithashtu rregulla alternative që do të duhet të zbatohen në raste emergjencash, atëherë kur procedurat normale anashkalohen.
- Reagim i dobët ndaj anomalive të raportuara. Sistemet e kontrollit janë konceptuar për t’ju përgjigjur rasteve të zakonshme ose normale. Megjithatë, që sistemet të mbeten efektive, është themelore që administratorët dhe supervizorët të jenë në gjendje t’u përgjigjen emergjencave në kohën e duhur. Rastet e papritura duhet të hetohen në kohë për të përcaktuar nëse në to përfshihet ndonjë parregullsi. Nëse është kështu, duhet të nisë menjëherë veprimi për ta vënë në vend. Mosmarrja e masave ndaj raportimeve të anomalive

në mënyrë efektive minon vetë efektivitetin e gjithë sistemit të kontrollit. Megjithatë, duhet patur kujdes që sistemi të mos bëhet aq i ndjeshëm sa të prodhojë “alarme fals”. Nëse kjo fillon të ndodhë shpesh, atëherë rrezikohet të injorohen alarme të vlefshëm.

- Marrëveshjet e fshehta. Çdo sistem kontrolli mund të minohet nëse një numër i mjaftueshëm individësh të pandershëm konspirojnë për të shkatërruar sistemin dhe janë në gjendje të falsifikojnë dokumentat kyç. Për këtë qëllim, ekziston një numër kontrollesh mjaft komplekse që vështirëson bashkimin e numrit të duhur të konspiruesve, por zbatimi i tyre është mjaft i kushtueshëm. Konspiracione të këtij lloji, zakonisht zbulohen dhe raportohen nga persona që nuk bëjnë pjesë në to, ose kur ka një përçarje mes pjesëtarëve të konspiracionit. Ato mund të dalin në dritë edhe gjatë një procesi rutine auditimi nëse përfshijnë shuma të mëdha ose nëse konspiruesit nuk kanë qenë të kujdesshëm në falsifikimin e dokumentave.
- Abuzimi nga ana e administratorëve kryesore. Kontrollat e brendshme konceptohen për të kontrolluar organizatën në interes të administratorëve, jo vetë administratorët (drejtuesit e organizatës). Ka shumë shembuj të administratorëve të pandershëm që i shmangen sistemit të kontrollit për të realizuar forma mashtrimi apo vjedhjeje. Megjithatë, në organizata të përmasave të mëdha, këto veprime zakonisht vërehen lehtë nga punonjësit. Por, mbrojtja më e mirë kundër abuzimeve të drejtuesve është krijimi i një mjedisi të hapur, në të cilin punonjësit janë të stimuluar për të raportuar parregullsitë e evidentuara, të sigurt që nuk do të ndëshkohen për pabesnikëri ndaj eprorëve të tyre. Një hapje e tillë në një organizatë bëhet pjesë e mjedisit të kontrollit.

Kontrollet e brendshme (të menaxhimit) janë pjesë themelore e strukturës dhe operacioneve të çdo organizate. Sa më të mëdha dhe komplekse të jenë organizatat dhe aktivitetet e saj aq më me kujdes duhet të konceptohen sistemet e kontrollit. Për të qenë plotësisht efektive, sistemet e kontrollit kanë nevojë për mbështetjen aktive të administratorëve gjatë ngritjes dhe mirëmbajtjes së tyre.

## **Ushtrimi 7**

Ku konsiston sistemi i informacionit i rëndësishëm për objektivat e raportimit financiar, që përfshijnë sistemet e kontabilitetit?

Cilat janë karakteristikat e komunikimit në lidhje me çështjet e raportimit financiar të entiteteve të vogla?

### **Përgjigje:**

- a) Sistemi i informacionit i rëndësishëm për objektivat e raportimit financiar, që përfshijnë sistemet e kontabilitetit, konsistojnë në:
  - procedurat dhe regjistrimet e hartuar e e themeluar për të ndërmarrë, regjistruar, procesuar, dhe raportuar transaksionet e entitetit) ashtu si ngjarjet dhe kushtet) dhe për të mbajtur kontabilitetin e aseteve, detyrimeve dhe kapitalit

- Zgjidhje e procesimit inkorrekt të transaksioneve, si për shembull, pezullimi automatik i skedarëve dhe procedura që ndiqen për të pastruar këto skedarë të pezulluar në kohë
  - Proçese dhe llogari për kontrollin e shkeljes së sistemeve
  - Transferimi i informacionit nga sistemet e procesimit tek logaritë e librit të madh
  - Kapja e informacionit financiar të rëndësishëm për ngjarjet dhe kushtet më shumë sesa për transaksionet, si zhvlersimi dhe amoetizimi i asetëve dhe ndryshimi në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme
  - Sigurimi i informacionit të kërkuar për tu zbuluar nga korniza e raportimit.
- b) Komunikimi i entitetit për rolet e raportimit financiar dhe përgjegjësive dhe çështjeve të rëndësishme të lidhura me raportimin financiar, përfshijnë pajisjen me të kuptuarin të roleve dhe përgjegjësive individuale të kontrollit të brendshëm mbi raportimin financiar. Përfshin çështje si zgjerimi ku personeli kupton sesi aktiviteti i tyre lidhet me sistemin e raportimit financiar dhe në punën e të tjerëve dhe mënyra raportimi të ngjarjeve të pazakonta në një nivel të përshtatshëm me entitetin.

Komunikimi mund të jetë më pak i strukturuar edhe më i lehtë për tu arritur në entitetet e vogla sesa në entitetet e mëdha si pasojë e niveleve të ulëta të përgjegjësive dhe largëpamësisë dhe aftësisë së menaxhimit.

## **Ushtrimi 8**

Para nxjerrjes së një raporti auditimi, në gazetë del një artikull në faqen e parë, sipas së cilit presidenti ka përdorur fondet e organizatës për qëllime personale. Audituesi ka informacion të mjaftueshëm për të konfirmuar pretendimet në artikullin e gazetës. Audituesi kontaktohet nga një gazetar për të konfirmuar faktet. Cila do të ishte përgjigja më e mirë e audituesit?

**Percaktoni se çfarë lloji opinionit do t'i leshojnë audituesit drejtimin? Pergatisni një ekstrakt ku të përmbajë paragrafin e opinionit, bazen për dhënie opinion dhe cdo paragraf tjetër që mendoni është relevant për rastin e shpjeguar më lart dhe është pjesë përbërëse e raportit të auditimit?**

### **Përgjigje:**

Audituesi nuk do t'i japë informacion gazetarit duke refuzuar të kthejë përgjigje, pasi të gjitha faktet dhe informacionet të siguruar në formën e evidencës së auditimit si rrjedhojë e zbatimit të procedurave të auditimit, janë konfidenciale dhe nuk i shpalosen publikut, përveç se kur shpalosja vjen si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e kërkesave të ligjit dhe rregulloreve.

Audituesi mundet të veprojë, duke raportuar në shkallë hierarkike. Ai duhet ta drejtojë çështjen tek Komiteti i auditimit ose të Bordi i Drejtorëve, ose në cdo strukturë vendim-marrese superiore të grupeve të interesit.

Audituesi nuk do t'i japë informacion gazetarit duke refuzuar të kthejë përgjigje, pasi të gjitha faktet dhe informacionet të siguruar në formën e evidencës së auditimit si rrjedhojë e zbatimit të procedurave të auditimit, janë konfidenciale dhe nuk i shpalosen publikut, përveç se kur shpalosja vjen si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e kërkesave të ligjit dhe rregulloreve.

Audituesi mundet të veprojë, duke raportuar në shkallë hierarkike. Ai duhet ta drejtojë çështjen tek Komiteti i auditimit ose te Bordi i Drejtorëve, ose në cdo strukturë vendim-marrese superiore të grupeve të interesit.

### **Ushtrimi 9**

Kompania KCRK shpk është një kompani e re në fushën e ndërtimit, e cila po rekruton staf të ri në të gjitha strukturat e saj. Kompania ushtron veprimtarinë në një zonë ekonomike të qëndrueshme. Për shkak të mungesës së kohës dhe progresit të shpejtë të veprimtarisë, kompania nuk ndoqi një procedurë shumë të thelluar të rekrutimit të stafit të financës, i cili nuk kishte eksperiencë të mëparshme në këtë fushë. Pas një viti punimesh, për shkak të një sëmundjeje të rëndë të papritur, nga kompania u largua drejtuesi kryesor i punimeve, i cili nuk dihej se kur mund të rikthehej përsëri në punë. Ndërkohë, drejtimi i kompanisë në mbledhjen e fundit të tij, kishte vendosur instalimin e një sistemi të ri informatik pagash, i cili do të lehtësonte kontabilizimin dhe regjistrimin e tyre.

**Bazuar në të dhënat e mësipërme, ju si auditues mendoni se ekzistojnë kushte apo ngjarje që tregojnë për rreziqe të anomalisë materiale?**

#### **Përgjigje:**

Bazuar në të dhënat e paraqitura në rastin studimor më sipër, ekzistojnë tre ngjarje apo kushte, të cilat tregojnë për rreziqe të anomalisë materiale, pavarësisht se veprimtaria e kësaj kompanie ushtrohet në një vend me ekonomi të qëndrueshme:

- Mungesa e personelit me aftësitë e duhura mbi raportimin kontabël dhe financiar, për shkak se nuk kishin eksperiencë të mëparshme në këtë fushë;
- Ndryshimet në personelin kryesor, përfshirë largimin e drejtuesve ekzekutivë kryesor. Sipas të dhënave të rastit, pas 1 viti u largua drejtuesi kryesor i punimeve;
- Instalimi i sistemeve të reja të rëndësishme të TI që lidhen me raportimin financiar. Sipas të dhënave, kompania kishte vendosur instalimin e një sistemi të ri informatik pagash, i cili do të lehtësonte kontabilizimin dhe regjistrimin e tyre.

### **Ushtrimi 10**

ELISI shpk. përdor sistemin e kostos për prodhimin për porosi për kontratat e klientëve që lidhen me sistemet e prodhimit për porosi të transformatorëve. Arditi shpk. porositi së fundmi 200 transformatorë dhe porosia u quajt #BA 35. Inspektimi final i transformatorëve zbuloi se 23 njësi ishin me defekte. Në korrigjimin e defekteve, u krye një kosto shtesë prej 200 \$ për materiale direkte dhe 800 \$ për punën direkte. Pasi u korrigjuan defektet, transformatorët u bashkuan me njësitë e tjera të mira dhe iu dërguan klientit.

Kërkohe të kryeni rregjistrimet në ditar per kryerjen e kostove të ripunimit nëse koeficienti i paracaktuar i rëndimit të shpenzimeve të përgjithshme të ELISI shpk. përfshin kostot normale të ripunimit, si edhe të tregoni efektin në koston totale të porosisë #BA 35.

### **Përgjigje:**

Rregjistrimi në ditar do të jetë:

SHPP 1000 \$

Te

Materiale Direkte 200 \$

Paga te pagueshme 800 \$

b) Efekti i kostove të ripunimit në vlerën 1000 \$ në koston e porosisë #BA35 do të jetë zero, pra vlera 1000\$ nuk përfshihet në koston e porosisë, sepse përcaktimi (llogaritja) i koeficientëve të paracaktuar bazohet duke përfshirë kostot normale të ripunimit.

Pra humbja normale parashikohet te të gjitha porositë, dhe koeficienti i paracaktuar i SHPP-së llogaritet duke përfshirë një vlerë të humbjes neto, e cila është e barabartë me koston e prodhimit me defekte ose të dëmtuar, minus çdo vlerë të vlerësuar të nxjerrjes jashtë përdorimit të atij prodhimi. Kostoja e parashikuar e prodhimit të dëmtuar u përfshi fillimisht kur u llogarit koeficienti i paracaktuar i rëndimit të SHPP-ve. Prandaj, kur ndodhin defektet apo dëmtimet, vlera e nxjerrjes jashtë përdorimit e prodhimit jo sipas standardeve (nëse është i shitshëm) përfshihet në inventar, ndërsa kostoja neto e humbjes normale për prodhimin jostandard i ngarkohet llogarisë sintetike të shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit, si në çdo SHPP faktike tjetër.

Nëse humbjet nuk ndodhin te të gjitha porositë, por ndodhin ndonjëherë në porosi të caktuara për shkak të karakteristikave të porosisë, kostoja e parashikuar nuk duhet të përfshihet në llogaritjen e koeficientit të paracaktuar të rëndimit të SHPP-ve dhe kostot e produkteve me defekt ose të dëmtuar i shtohen koston së porosisë, dhe vlera e nxjerrjes jashtë përdorimit të produkteve të tilla redukton koston e porosisë që krijoi ato produkte.